

## 1

**Vlerësimi i cilësisë së dijeve te studentët dhe standardet përkatëse****1 Sistemi i diferencuar i vlerësimit të cilësisë së dijeve të studentëve**

1.1. Për kontrollin dhe vlerësimin e cilësisë së dijes së studentëve në UE, mbi bazën e sistemit të vlerësimit me kreditë gjatë procesit mësimor, në përputhje me rregulloret në fuqi përdoret vlerësimi me sistemin me 10 nota. Duke u mbështetur në përvojat mbi vlerësimin, paraqesim një klasifikim të përafërt të këtij sistemi, përshtatur me vlerësimin sipas standardeve ECTS:

**Sistemi i vlerësimit në universitetet shqiptare dhe Sistemi Evropian i Transferimit të Krediteve (ECTS)**

Shkalla ECTS e notave	Shkalla e notave	Përcaktimi i nivelit të formimit
A	10	SHKËLQYESHËM - i dalluar me pak gabime të vogla
B	9	SHUMË MIRË - mbi nivelin mesatar, me disa gabime
C	7-8	MIRË - punë në përgjithësi e mirë, me një numër të konsiderueshëm gabimesh
D	6	KËNAQSHËM - përgatitje e zbehtë dhe me gabime të mëdha
E	5	MJAFTUESHËM - formim që plotëson kushtet minimale për të kaluar
FX	4	MBETËS - i nevojitet më shumë punë për të fituar kreditet
F	1-3	MBETËS - i nevojitet punë shumë e madhe për të qenë kalues

Marrë nga suplementi i UE-së

## FORMAT E KONTROLLIT TË CILËSISË SË DIJES SË STUDENTËVE

Gjatë organizimit të procesit mësimor me përdorimin e sistemit të krediteve akademike përdoren lloje të ndryshme të formave të kontrollit për vlerësimin e cilësisë së dijes së studentëve.

1 – Kontrolli i vazhdueshëm (**Kv**)

2 – Kontrolli i ndërmjetëm (**Kn**)

3 – Kontrolli përfundimtar (**Kp**)

**2.1 Kontrolli i vazhdueshëm (Kv)**

2.1.1. Kontrolli i vazhdueshëm ka për qëllim të ndikojë në mënyrë vepruese në cilësinë e auditorit dhe punës së pavarur të studentëve, në rrjedhën e zhvillimit të modulit të disiplinës mësimore gjatë semestrit.

2.1.2. Format e kontrollit të vazhdueshëm, në përputhje me specifikat lëndore, mund të jenë: pjesëmarrja aktive, vëzhgimi, referati, artikulli, përmbledhja, detyrat praktike, seminarët, kontrolli në auditor dhe jashtë auditorit, punët e kontrollit, esetë, detyrat e shtëpisë gjykimet për çështjet e ngritura për diskutim etj.

2.1.3. Gjatë kontrollit të vazhdueshëm vlerësohet përgatitja dhe gatishmëria e studentëve në punë të pavarura, seminarë, vlerësohet shkalla e përvetësimit të materialit mësimor, niveli i të kuptuarit në auditor, mangësitë e dala në përvetësimin e materialit mësimor dhe synohet përmirësimi i metodologjisë së mësimdhënies në disiplinën e dhënë dhe aktivizimi i studentëve më tej.

2.1.4. Kontrolli i vazhdueshëm i cilësisë së dijes së studentëve përcillet te pedagogu edhe nëpërmjet dijeve praktike, seminarëve, ushtrimeve apo punëve laboratorike.

2.1.5. Gjatë formave të dhëna të kontrollit të vazhdueshëm pedagogu duhet të bëjë me dije edhe vlerësimin e cilësisë së përgatitjes dhe gatishmërinë e të gjithë studentëve të grupit të dhënë, kursit apo grupit laboratorik. Vlerësimi në formën e kontrollit të vazhdueshëm arrihet vetëm nëse kontrolli përfshin një numër të madh studentësh.

2.1.6 Rezultatet e kontrollit të vazhdueshëm realizohen me 10 nota.

2.1.7. Metodatat e realizimit të kontrollit të vazhdueshëm përcaktohen nga pedagogu i lëndës dhe shënohen në programet mësimore të disiplinës përkatëse.

2.1.8 Gjatë mungesës së detyrave praktike apo seminareve në lëndë të veçanta vlerësimi bëhet nga pedagogu (lektori) duke u mbështetur në specifikat e disiplinës së dhënë, e përshkruar kjo dhe në programin lëndor të disiplinës së dhënë.

2.1.9 Rezultatet e kontrollit të vazhdueshëm do të kenë peshën e vet specifike në vlerësimin që bëhet në përputhje me tabelën dhe formulën si shumë e vlerësimit të përbërësve të veçantë me peshën specifike të vlerësimit të përgjithshëm, shuma e të cilit do të jetë e barabartë me 1 ( $\sum Ki=1$ ).

	Përbërësit e kontrollit të vazhdueshëm	Pesha specifike në zërin që rezulton nga vlerësimi i kontrollit të vazhdueshëm ( <b>Ki</b> )	Vlerësimi i kontrollit të vazhdueshëm ( <b>Vi</b> )
1	Detyrë kontrolli		
2	Ese		
3	Referat		
4	Detyrë praktike		
5	Seminar		
6	Test		
7	Pjesëmarrje aktive në leksione, ushtrime, seminare		
8	Laborator etj.		
Vlerësimi përfundimtar i kontrollit të vazhdueshëm ( <b>Vkv</b> )			

4

2.1.10 Vlerësimi që rezulton nga kontrolli i vazhdueshëm përcaktohet në përputhje me tabelën e dhënë më sipër dhe formulën si përmbledhje e të

gjithë përbërësve të kontrollit të vazhdueshëm, të llogaritur sipas peshës specifike që ata zënë, shuma e së cilës duhet të jetë e barabartë me 1 ( $\sum Ki=1$ ):

$$Vv = \sum Ki \times Vkvi., \text{ ku}$$

Vkv – vlerësimi që rezulton nga kontrolli i vazhdueshëm;

Vi – vlerësimi i i-të i kontrollit të vazhdueshëm;

Ki –pesha specifike e përbërësit të i-të kontrollit të vazhdueshëm në vlerësimin që rezulton nga ky kontroll.

2.1.11 Të gjitha rezultatet si dhe përbërësit për nxjerrjen e rezultateve në kontrollin e vazhdueshëm u bëhen të ditur studentëve dhe atyre u lind e drejta për diskutim apo kontestim rezultatesh.

#### Kontrolli i ndërmjetëm (Kn)

2.2.1. Kontrolli i ndërmjetëm kryhet me qëllim vlerësimin e përvetësimit të një pjese të dhënë të disiplinës mësimore.

2.2.2. Kontrolli i ndërmjetëm zhvillohet në fund të çdo kapitulli ose përmbledhje kapitujsh të disiplinës mësimore dhe mund të përkojë me një seminar përmbledhës, kolokium të disiplinës së dhënë mësimore, detyrë afatgjatë apo të formave të tjera të përcaktuara në programin lëndor.

2.2.3 Kontrolli i ndërmjetëm edhe mund të realizohet në formën e një pune kontrolli në disiplinën e dhënë mësimore. Mënyrat e kryerjes së këtij kontrolli specifikohen sipas disiplinës.

2.2.4. Afati i kryerjes së kontrollit të ndërmjetëm në fund të çdo kapitulli ndryshon në kohë dhe përshkruhet në programin mësimor të disiplinës së dhënë.

5

Periudha për kryerjen e kontrollit të ndërmjetëm	Periudha më e përshtatshme për kryerjen e Kn-së
Kontrolli i ndërmjetëm në fund të kapitullit xxx <b>(java 4-6 e semestrit)</b>	<b>(java V e semestrit)</b>
Kontrolli i ndërmjetëm në fund të kapitullit yyy <b>(java 9-11 e semestrit)</b>	<b>(java X e semestrit)</b>
Kontrolli i ndërmjetëm në fund të kapitullit zzz <b>(java 13-15 e semestrit)</b>	<b>(java XIV e semestrit)</b>

- 2.2.5. Rezultatet e shpallura të kontrollit të ndërmjetëm vlerësohen në çdo rast me 10 nota, në përputhje me formën e plotësimin të rezultatit të kontrollit të ndërmjetëm.
- 2.2.6. Peshat specifike e të gjitha formave (përbërësve) të kontrollit të ndërmjetëm duhet të përgatitet kohë më parë nga pedagogu me llogaritjet specifike të disiplinës së dhënë, të përshkruar në programin mësimor dhe me dijeni të plotë të studentëve që në fillim dhe në vijimësi të zhvillimit të disiplinës së dhënë.
- 2.2.7. Vlerësimi përfundimtar i kontrollit të ndërmjetëm (Vkn) përcaktohet si e mesme e shumës që rezulton nga vlerësimi i kontrollit të vazhduar (Vkv.) dhe vlerësimin të kontrollit të ndërmjetëm (Vn), duke llogaritur dhe peshën specifike në vlerësimin që rezulton në kontrollin e ndërmjetëm:

$$Vn = Kv \times Vkv + Kn \times Vkn,$$

ku ( $Kvi + Kni = 1$ ).

Të dhënat paraqiten si më poshtë:

6

	Përbërësit e kontrollit të vazhdueshëm (Vi)	Pesha specifike e përbërësit të vlerësimin të vazhdueshëm në	Vlerësimi përfundimtar i kontrollit të

		kontrollin e ndërmjetëm (Ki)	ndërmjetëm (Vkn)
1	2	3	4
1	Vlerësimi që rrjedh nga kontrolli i vazhdueshëm (Vkv)		
2	Vlerësimi që rrjedh nga kontrolli i ndërmjetëm (Vni)		
Rezultati përfundimtar i kontrollit të ndërmjetëm (Vkn)			

- 2.2.8. Pedagogu në përputhje me programin mësimor mund të mos realizojë kontroll të vazhdueshëm, por të kryejë kontroll të ndërmjetëm (detyrë kontrolli) apo dhe anasjelltas. Në këtë rast pesha specifike e kontrollit të vazhdueshëm merret e barabartë me 0, ndërsa pesha specifike e kontrollit të ndërmjetëm merret e barabartë me 1 (apo anasjelltas).
- 2.2.9. Vlerësimi që rezulton nga kontrolli i ndërmjetëm përcaktohet në përputhje me tabelën e mëposhtme dhe formulën përkatëse si shumë e vlerësimeve të kontroleve të ndërmjetme me llogaritjen e peshës specifike, ku edhe këtë radhë shuma duhet të jetë  $\sum Kni=1$ :

$$VN = \sum Kni \times VKni.$$

	Kontrollet e ndërmjetme (Vkni)	Pesha specifike në rezultatit e vlerësimin në kontrollin ndërmjetëm (Kni)	Vlerësimi përfundimtar i kontrollit të ndërmjetëm (VN)
1	2	3	4
1	Rez. i kontrollit të parë të ndërmjetëm (Vkn1)		
2	Rez. i kontrollit të dytë të ndërmjetëm (Vkn2)		
i	Rez. i kontrollit të i-të të ndërmjetëm ((Vkni)		

7

- 2.2.10 Vlerësimi që buron nga kontrolli i ndërmjetëm llogaritet me 10 nota, me saktësi deri në të dhjetën (të qindtën), dhe shërben

njëkohësisht si informacion dhe argument për rezultatet e arritura, duke nxjerrë dhe përfundimet përkatëse. Rezultatet në të gjitha etapat afishohen dhe u bëhen të ditur studentëve, si në vlerësimin e vazhdueshëm, ashtu dhe në atë të ndërmjetëm.

### 2.3. Kontrolli përfundimtar

- 2.3.1. Format e kryerjes së kontrollit përfundimtar janë provimi me shkrim, provimi me gojë, si dhe provimi me shkrim dhe me gojë.
- 2.3.2. Kontrolli përfundimtar ka për qëllim të njohë dhe të vlerësojë dijet dhe detyrat praktike të studentëve në disiplina konkrete.
- 2.3.3. Kontrolli përfundimtar kryhet në mbarim të semestrit apo vitit mësimor, në përputhje me programin mësimor të disiplinës së dhënë.
- 2.3.4. Rezultatet e kontrollit përfundimtar bëhen nëpërmjet vlerësimit me 10 nota apo të qenit kalues ose jokalues, në përputhje me planin mësimor.
- 2.3.5. Vlerësimi i kontrollit përfundimtar komunikohet nga pedagogu në takimin me studentët, duke dhënë vlerësimin përkatës.
- 2.3.6. Zhvillimi i kontrollit përfundimtar me tregues datën, orën e vendin kryhet me dijeni të dekanit (përgjegjësit të departamentit), në marrëveshje të pedagogut me studentët në jo më pak se një javë nga fillimi i sezonit të kontrollit përfundimtar.
- 2.3.7. Përmbajtja dhe format e kryerjes së kontrollit përcaktohen në programin e disiplinës mësimore dhe u bëhet e qartë studentëve në fillim të procesit të mësimdhënies së disiplinës.
- 2.3.8. Në kontrollin përfundimtar të disiplinës së dhënë përfshihen

8

vetëm ata studentë të cilët në një përqindje të konsiderueshme kanë ndjekur dhe realizuar programin mësimor, minimalisht jo më

pak se X% në përputhje me rregulloren e studimeve në UE. Nëse një student nuk ka ndjekur mbi X% të përbërësve të vlerësimit të vazhdueshëm apo të ndërmjetëm, nuk i nënshtrohet kontrollit përfundimtar në disiplinën e dhënë mësimore dhe për rrjedhojë nuk kreditohet në atë disiplinë.

- 2.3.9. Përbërësit e kontrollit përfundimtar janë produkt që rezultojnë edhe nga kontrolli i ndërmjetëm mbi bazën e llogaritjeve të thjeshta me të njëjtën logjikë si ajo e kontrollit të ndërmjetëm.
- 2.3.10. Çdo përbërës i vlerësimit të kontrollit përfundimtar duhet të zërë një peshë specifike, e cila duhet të përcaktohet më parë nga pedagogu mbi bazën e të dhënave specifike të disiplinës së përshkruar në programin mësimor të saj dhe të vendoset përfundimisht duke i njoftuar studentët në fillim të semestrit.
- 2.3.11. Vlerësimi që kryhet në kontrollin përfundimtar përfaqëson një vlerësim me peshë që rezultojnë edhe nga përbërësit e tjerë, si kontrolli i ndërmjetëm dhe kontrolli përfundimtar,

$$Vp = VN. \times Kn. + Vkp. \times kp.,$$

ku **kn.**-ja është pesha specifike e vlerësimit që rezultojnë nga kontrolli i ndërmjetëm në krahasim me peshën e vlerësimit të kontrollit përfundimtar (jo më pak se 50% dhe jo më shumë se 60% dhe e përcaktuar në programin e lëndor);

**kp.**-ja është pesha specifike e vlerësimit që rezultojnë nga kontrolli përfundimtar (jo më shumë se 50% dhe jo më pak se 40%, dhe kjo e përcaktuar në programin lëndor);

- 2.3.12. Përmbajtja e mënyrës dhe e formës së kryerjes së kontrollit përfundimtar përcaktohet në programin e disiplinës së dhënë mësimore. Studentët duhet të mirinformohen për

9

mënyrën e zhvillimit të procesit të vlerësimit.

- 2.3.13. Plotësimi i procesverbalit të provimit dërgohet në sekretarinë e fakultetit pas kryerjes dhe përfundimit të kontrollit përfundimtar.
- 2.3.14. Procesverbal i provimit firmoset nga dekani, kryesekretari dhe për çdo vlerësim të studentëve firmoset nga komisioni i provimit, ku përfshihet pedagogu që zhvillon kontrollin përfundimtar, të ndërmjetëm apo të vazhdueshëm. Gjithçka përcaktohet në përputhje me rregulloret e strukturave të institucionit.
- 2.3.15. Format e plotësimit të rezultateve të kontrollit të vazhdueshëm, të ndërmjetëm dhe përfundimtar japin formimin e çdo studenti në disiplinën e dhënë.

#### Dokumentacioni

- 2.4.1 Rezultatet e kontrollit të vazhdueshëm bëhen me dije përpara fillimit të vlerësimit për kontrollin e ndërmjetëm. Forma e paraqitjes caktohet në departament në përputhje me specifikat lëndore.
- 2.4.2. Rezultatet e kontrollit të vazhdueshëm janë pjesë e dokumentacionit të pedagogut dhe argument për vlerësimin e tij në përbërësin e vlerësimit të ndërmjetëm.
- 2.4.3. Materialet për vlerësimin e këtij dokumentacioni bëhen në përputhje me standardet e miratuara nga rektorati në lidhje me këtë pike (shih modelet e dhëna).
- 2.4.4. Në përfundim të vitit shkollor një kopje e rezultateve të dhëna depozitohet në departament në letër dhe në rrugë elektronike. Dorëzohet gjithashtu dhe një kopje në degën mësimore për të dhëna statistikore.
- 2.4.5 . Rektorati, në bashkëpunim me degën mësimore, ngarkohet me përgatitjen e dokumentacionit standard për pedagogët, departamentet dhe sekretaritë në lidhje me këtë çështje.

1 – Kontrolli i vazhdueshëm (**Kv**) Vlerësimi i vazhdueshëm(**Vv**)

$$Vv = \sum Ki \times Vkvi., \text{ ku}$$

**Vkv** – vlerësimi që rezulton nga kontrolli i vazhdueshëm;

**Vi** – vlerësimi i i-të të kontrollit të vazhdueshëm;

**Ki** –pesha specifike e përbërësit të i-të kontrollit të vazhd

2 – Kontrolli i ndërmjetëm (**Kn**) Vlerësimi i ndërmjetëm **VndheVN**

A - Vlerësimi i ndwrnjetwm qw i takon njw kontrolli tw ndwrnjetwm

$$Vn = Kv \times Vkv + Kn \times Vkn, \text{ ku } (Kv + Kn = 1).$$

B – Vlerësimi i ndërmjetëm si komponentë te vlerësimit përfundimtar(**VN**)

$$VN = \sum Kn_i \times VKn_i$$

3 – Kontrolli përfundimtar (**Kp**)

$$Vp = VN. \times KN. + Vkp. \times kp.,$$

**KN** –pesha specifike e komponentit të ndwrnjetwm

**kp** pesha specifike e kontrollit përfundimtar.